



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZLAnr.370/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Zyhdi Haziri dhe Faton Ademi anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Fitore Isufi, duke vendosur përkritazi me ankesën e kandidates për anëtare të Kuvendit Komunal të Hanit të Elezit, Samire Curri, nga radhët e subjektit politik LDK, me seli në Prishtinë, dega Hani i Elezit, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me 24.10.2017 mori këtë:

V E N D I M

HUDHET si e pa rregullt ankesa e kandidates për anëtare të Kuvendit Komunal të Hanit të Elezit, Samire Curri, nga radhët e LDK-së, me seli në Prishtinë, dega në Hani i Elezit, me numër ZL.Anr.370/2017 e datës 23.10.2017, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të 22.10.2017,

A r s y e t i m

Me datën 23.10.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Samire Curri nga radhët e LDK-së, me të cilën pretendon se në Vendvotimet: 3301/01, 3301/02, 3301/03, 3301/04, 3301/05 dhe 3302/01, nuk janë as votat e familjarëve dhe votuesve tjerë.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të rregullsisë së ankeses gjeti se:

Ankesa është e pa rregullt


PZAP-i, nga shkresat e lëndës vlerësoj se ankesa e parashtruar nga ana Samire Curri, nga radhët e LDK-së, me seli në Prishtinë, dega në Hani i Elezit, është e parregullt, sepse nuk është e nënshkruar nga Samire Curri dhe si e tillë ankesa nuk i plotëson kriteret e Rregullës Nr.02/2015 të nenit 5.6, ku përcaktohet se: Ankesat duhet të dorëzohen me shkrim dhe duhet të jenë të nënshkruara nga ankuesi apo në emër të tij nga i autorizuari.

Prandaj PZAP-i, nuk u lëshua fare në meritat e ankesës, ngase nuk janë plotësuar kushtet e kërkuara nga dispozitat e lartëtheksuara.

Nga arsyet e sipërshënuar e në mbeshtejte të nenit 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it dhe në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZLAnr.370/2017 më datën 24.10.2017.

Kryesuesi i Panelit
Rafet Haxhaj



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.